



P.nr.3195/2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Shtimja rruga [REDACTED], i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1412-2/16 të dt. 11.12.2017, sipas së cilës e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.08.02.2018 solli:

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1412-2/16 të dt. 11.12.2017, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] nga Shtimja rruga "[REDACTED]", i lindur me datë [REDACTED] në të njëjtin nga i ati [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal, mbrohet në liri me numër personal [REDACTED].

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 06.08.2016, rreth orës 03:10, në rrugën magjistrale Ferizaj- Shtime, e me të arritur në vendin e quajtur Porodime, Komuna Shtime, duke drejtuar automjetin e markës "VW Golf", me targa te regjistrimit [REDACTED] duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 53/1 të LSKRR-së, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës, humb kontrollin ndaj timon dhe e godet me pjesën e pasme automjetin e markës "VW Golf", me targë të regjistrimit [REDACTED] të cilin e drejtonte [REDACTED] e cila ishte në lëvizje dhe nga goditja del jashtë rrugës në anën e majtë me të cilin rast t pos dëmeve materiale lëndime të lehta trupor pëson [REDACTED] dhe [REDACTED] lëndime këto të përshkruara në ekspertizën mjeko - ligjore të datës 29.11.2017,-

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin [REDACTED], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuarit: [REDACTED] nga [REDACTED] dhe [REDACTED] nga [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 60.88 Euro dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1412-2/16 të dt. 11.12.2017, ka akuzuar [REDAKTUAR] nga Shtimja rruga "[REDAKTUAR]", për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimit kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimit, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimit.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht konstatimin e ekspertit mjeko ligjor i dt.29.11.2017, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 18.09.2017, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarit: [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e viktmave të krimin Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P.nr.3195/2017 i dt.08.02.2018

Gjyqtari

Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimit bëhet plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.